



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 12/2019), Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK) në seancën e 83- të të mbajtur më 27.02.2023 miratoi,

### **Vendim**

Procedura për kontrollin e të dhënave për gjendjen pronësore nga fleta anketuese të \_\_\_\_\_, ministër në \_\_\_\_\_ të Qeveris së RMV-së, NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm të KSHPK-së sipas lëndës me numër 08-4167/1 të datës 04.09.2019.

Lënda me numër 08-4167/1 të datës 04.09.2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetimin në formë të depersonalizuar të publikohet në veb faqen e KSHPK-së në afat kohor prej 5 (pes) ditëve nga dita e miratimit.

### **Arsyetim**

Lënda me numër 08-4167/1 të datës 04.09.2019 është formuar me vetiniciativë, ndërsa në bazë të planit vjetorë për monitorimin e gjendjes pronësore dhe interesave për vitin 2019.

KSHPK-ja nga personi i emëruar kërkoi informacion për anëtarët e familjes së tij me të cilët jeton në një familje të përbashkët.

Nga i emëruari u dorëzuan të dhënat e kërkuara.

Me qëllim vërtetimin e gjendjes faktike në rastin konkret, KSHPK-ja ka marrë të dhëna për pasurinë e \_\_\_\_\_ dhe familjarëve të tij nga Agjencia e Kadastrës së Pasurive të Paluajtshme, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e të Ardhurave Publike, Depozita Qendrore e Letrave me Vlerë dhe Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nga analiza e realizuar e dokumentacionit të marrë, KSHPK-ja ka konstatuar se personi \_\_\_\_\_ ka fituar ½ pronësi mbi pasurinë e paluajtshme me sipërfaqe 464 m<sup>2</sup> në rrugën \_\_\_\_\_ nr. \_\_\_\_\_ në Shkup me vlerë 27.840.000,00 denarë. Me qëllim vërtetimin e mënyrës së blerjes dhe mënyrën e financimit të pronës së sipërpërmendur, KSHPK-ja kërkoi informacion shtesë nga personi i përmendur në rastin konkret \_\_\_\_\_, nga institucionet financiare në territorin e RMV-së si dhe nga bashkë- pronari i paluajtshmerisë \_\_\_\_\_.

KSHPK, nga të dhënat e marra nga institucionet e përmendura si dhe nga të dhënat nga fleta anketuese i dorëzuar nga i emëruari, konstaton se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent në rastin konkret.

Në bazë të sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



KOMISIONI SHTEËTORË  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
Nënkryetar  
**Katica Nikolovska**

---